



Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 7 paragrafi 1, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 14 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 paragrafi 3, nenit 12 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës datë 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim jepet në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluajtshmeria-prona komunale për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore apo të ngjajshme që gjindet në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve me shenimet si në tabelën si në vijim

Nr	Pronar	Zona Kadastrale	Parcela Kadastrale	Sipërfaqe e përgjithshme m ²	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1.	Komuna Lipjan	Babush i Muhaxherëve	P-71409059-00562-7	104251	20493

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi prona komunale jepet në shfrytëzim në periudhen afatshkurtër prej 10 (dhjetë) viteve nëpërmjet ankandit publik dhe çmimi fillestar do të

jetë prej 50 € (euro) për 1 ha (hektar) për pronën duke u bazuar në vendndodhjen e saj, ndërsa do të kenë mundësi të përfitojnë personat fizik dhe juridik që ofrojnë çmimin më të lartë. Prona e propozuar është publikuar brenda afatit ligjor në faqen zyrtare të komunës sipas Vendimit 15Nr.942/03-67385 të Kuvendit të Komunës së Lipjanit datë 22.12.2022 për publikim të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues 2023, konform dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës komunale siç përcaktohet në neni 1 të këtij Vendimi është që sipërfaqja e pronës komunale, të jepet në shfrytëzim personave fizik dhe juridik për zhvillimin e veprimtarisë bujqësore apo të ngjajshme me interes për komunën.

Neni 4

Procedura e vlerësimit të ofertave mund të zhvillohet edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatshkurtër siç përcaktohet në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 462/01-16381

Lipjan, më 31.03.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi